DRTK SHKODËR

MIRATOHET

Sekretari i K. K. T. K. M

Ark. Joli Mitrojorgji

SPECIFIKIME TEKNIKE

Objekti : Punime restaurimi në monumentin "Banesa e Ramiz Podgoricës"

1. Çmontim dyer dritare

Ky çmim jepet në lek/m2 dhe përfshin heqjen në këtë rast nga murtaura të cdo lloj dritareje, dere dhe grile të specifikuar në projekt. Heqja e dyerve, dritareve dhe grilave do të bëhet me kujdes në mënyrë që të mos dëmtohet muratura.

2. F.V Dritare druri kase binar teke xham

Furnizimi i dritareve do kryhet nga kontraktori përkatës nga vendi i prodhimit ose blerjes deri në objekt. Dritaret do të jenë riprodhim i dritares së vjetër përkatëse. Në rast mungese të një detaji për rindërtim, detaji do të aprovohet nga supervizori.

3. Restaurim dyer druri

Dyert ekzistuese do të çmontohet me kujdes, do i shtohen të gjithe elementet e rëna dhe ato ekzistuese do restaurohen me të njëjtat materiale. Pasi të jenë plotësuar me elementet që mungojnë ose me eelementet e demtuar dhe të jenë lyer me vaj lini, dyert do të montohen aty ku janë hequr.

4. Shërbetisje e bojatisje me gëlqere

Bojatisja me gëlqere do kryhet sipas projektit. Materiali i përdorur do jetë gëlqere me konsistence të lartë. Shkrirja e gëlqeres në ujë do bëhet në mënyrë që të kemi konsistencë të përshtatshme të shërbetit për lyerje. Lyerja do të kryhet me dy faza. Faza e parë do jetë për krijim e bazës dhe mbulimin e faqeve të palyera që janë të reja. Faza e dytë do jetë për mbulimin e plotë dhe dhënien ngjyrës së bardhë që kërkohet të arrihet.

5. Prishje suvatimi

Në ambientet e brendshme të banesës vihen re plasaritje të suvatimit. Ato janë krijuar ndër vite si rezultat i disa faktorëve të ndryshem. Prishja do bëhet në të gjithë sipërfaqen e mbushur me plasaritje dhe do të bëhet pastrimi i plotë deri në daljen e muraturës; larje të sipërfaqeve të pastruara me ujë me presion për largimin e pluhurave dhe papastërtive. Ky zë perveç prishjes përfshin edhe largimin e materialeve të nxjerra nga prishja. Ky çmim është Lekë/ m2.

6. **Suva brenda mur guri me krah, llaç gelqere 1:2**

Siperfaqja e suvatuar do te kontrollohet e gjitha duke evituar suvatimin e shkeputur te pa pikturuar, i cili do te prishet deri ne gur. Do te evidentohen çarjet e mundshme. Muret do te lahen me uje te bollshem duke pastruar siperfaqen nga pluhurat. Llaci i suvase nuk duhet te aplikohet ne temperature me te madhe se 5ºC. Rera per suva duhet te jete e perbere nga kokriza te dimensioneve te tilla per te kaluar ne site me permasa 1mm. Ne kete ze punimesh perfshihen cmimet qe duhen per te realizuar sipas kushteve teknike riparimet e suvatimeve te mureve te brendshme guri, pergatitja e siperfaqes se murit pastrimi nga pluhuri, lagia, vendosja e shtreses se suvase deri ne tharje, dora e dyte, dhe finoja.

7. **Prishje mur guri**

Pasi eshte evidentuar zona e murit ku do te hapet per dritaren, do kalohet ne fazen e prishjes se tij. Duke siguruar me pare zonen per te parandaluar aksidentet e mundshme, ne zona te ulta para se te kalojme ne procesin e prishjes te kontrollohet qendrueshmeria e elemeteve dhe struktura qe varen nga ekzistenca e murit. Me prishje do kuptojme shkeputjen e gureve nga llaci lidhes si dhe pastrimi i tyre me furca metalike. Te kihet kujdes ne momentin e transportit te tyre.

8. **Restaurim grila druri**

Ky zë i referohet restaurimit në vepër të grilave të drurit. Të gjitha elementet që do të restaurohen tek grilat duhet të realizohen me dru pishe të stazhionuar në mënyrë natyrale, të paktën 5 vjeçare. Elementet duhet të trajtohen me dy duar antimol dhe vaj lini antimol përpara se të montohen në vepër. Kujdes i veçantë duhet të tregohet gjatë montimit të tyrë, në mënyrë që të vendosen sa më mirë në hapësirat e tyre përkatëse, duke i'u përshtatur vendosjes ekzistuese

Punoi: Fatjon Mlloja

Sabrina Kuçi

Elson Laqja

Fatjon Mlloja — Digitally signed by Fatjon Mlloja Date: 2025/11/21 13:18:33 +02'00' 95f997089d75493e9a5f2567c3b69

Elson Laqja — Vulosur elektronikisht nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Digitally signed by Elson Laqja Date: 2025.09.25 14:20:05 +02'00'

Sabrina Kuci — Digitally signed by Sabrina Kuci Date: 2025.09.25 15:44:08 +02'00'

Helidon Sokoli — Digitally signed by Helidon Sokoli Date: 2025.10.07 09:30:08 +02'00'

Kiara Xhelili — Digitally signed by Kiara Xhelili Date: 2025.11.21 13:12:08 +02'00'

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore)